

Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore. 12. Terminologjia e Arkitekturës (shqip-rusisht-frengjisht). Botim i Sektorit të Terminologjisë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë (Universiteti Shtetëror i Tiranës), Tiranë, 1963, 102 f.

Botimi në seri i fjalorëve të terminologjisë tekniko-shkencore është një ngjarje me rëndësi për jetën shkencore në vendin tonë. Dalja e tyre në dritë është një tregues i qartë i sukseseve të arritura deri tani në gjuhësinë shqiptare, suksese që mund të arriheshin vetëm nga një punë këmbëngulëse me të vërtetë shkencore në lëmin e terminologjisë të mbështetur në realitetin ekonomik e shoqëror të kohës.

«Terminologjia e arkitekturës» përbën vëllimin e dymbëdhjetë në serinë e fjalorëve terminologjikë me titullin e përbashkët «Fjalor i Terminologjisë tekniko-shkencore». Në këtë fjalor pasqyrohet pjesa më e madhe e termave të arkitekturës që kanë të bëjnë me mënyrën e ngritjes së mureve, me stilet e ornamentet dhe një pjesë e termave të ndërtimeve; fjalori përmban 1597 terma në tri gjuhë (shqip-rusisht-frengjisht) me indeksat rusisht e frengjisht.

Ky fjalor është fryt i një pune të gjatë kolektive gjuhëtarësh e specialistësh të kësaj dege të shkencës. Ai është i pari fjalor tekniko-shkencor i terminologjisë shqipe të arkitekturës, i cili do t'u bëjë të njohur pedagogëve, specialistëve të kësaj fushe dhe gjithë punonjësve të prodhimit jo vetëm mundësitë reale që ka gjuha për të shprehur nocionet e arkitekturës me terma shqip, por dhe do të ndihmojë në njësimin e kësaj terminologjie, në përdorimin e njejtë të saj në shkolla, institucione shkencore ose qendra prodhimi. Ky fjalor është kurorëzim i punës së hartuesve të tij për zgjidhjen e tre problemeve me rëndësi: 1) njësimi i terminologjisë; 2) pastrimi i terminologjisë nga ngarkesa e tepërme me fjalë të huaja; 3) pasurimi i saj për të përmbushur nevojat gjithnjë më të mëdha që paraqet ndërtimi i socializmit në vendin tonë.

Karakteristika kryesore e këtij fjalori është se terminologjia e tij është mbështetur më shumë se të tjerat në gjuhën popullore dhe veçanërisht në atë të zejës popullore të muratorit. Bazën e kësaj terminologjie e përbëjnë fjalë-termat popullore lidhur me ndërtimin, drejtpërdrejt ose tenthorazi psh. *ballë, brez, daltë, deltinë, faqe, frangji, fundje, fushak, gërshërëz, gur, mahi* etj. Duke përdorur këto fjalë-terma si tema prodhuese dhe duke çfrytëzuar sa më shumë mënyrat dhe tipat më produktivë të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme shqipe, janë sajuar terma që i japin kësaj terminologjie një karakter të spikatur popullor psh. nga *ballë*-i (rus. *фасада*, fr. *façade*) janë formuar fjalë-termat *ballëz*-a për rus. *подступенок*, fr. *contre-marche*, *ballëzinë*-a, për rus. *фронтон*, fr. *fronton*, *bollor*-i për rus. *главный фасад*, fr. *frontispice*, *dyballor*-e për rus. *с двумя фасадами* fr. *à deux façades*; nga *daltë*-a (rus. *скарпель*, fr. *ciseaux*) është sajuar fjalë-termi *daltari*-a (skulpturë); nga *lule*-ja janë sajuar fjalë-termat *lulim*-i ose *lulonje* për rus. *орнамент в виде цветов*, fr. *freston*, *lulevarg*-u për rus. *гирланда*, fr. *guirlande*; nga *rrjetë*-a (rus. *ожурная*

кладка, fr. reseau) janë formuar fjalë-termat *rrjetëz-a* për rus.

свинцовые оправы, составляющие сеть для застекления, fr. résille, *rrjetëzake* për rus. с ромбической перевязкой (кладка), fr. réticule, etj.

Gjithashtu duke u nisur nga tema prodhuese jo shqipe, me anë sufiksesh, është bërë përpjekja për të shqipëruar disa fjalë-terma jo ndërkombëtare, psh. me sufiksin *-esë* është formuar *armatesë* për rus. *арматура*, fr. armature, ose me sufiksin *-o* është formuar fjalë-termi *armo*, për rus. *армировать*, fr. armer.

Por, na duket, dëshira e madhe për të pastruar terminologjinë e arkitekturës nga fjalët e huaja i ka shpënë hartuesit e fjalorit deri në formime të atilla, që zakonisht nuk janë të natyrës shqipe, p.sh. është sajuar termi *shkalla e pacaktuarësisë së sistemit* (1258). Mendojmë se fjala *pacaktuarësi* nuk është formuar sipas natyrës së gjuhës sonë. Në bazë të analizës së fjalëformimit, kjo fjalë është formuar nga mbiemri participor *i pacaktuar* dhe sufiksi *-(ë)si*. Por, «nga mbiemra të tillë participorë me parashtesën mohuese *pa-* emra abstrakte cilësie me prapashtesa zakonisht nuk formohen»¹. Vetë fjala *pacaktuarësi* nuk pasqyrohet në fjalor si term më vehte. E njëjta gjë ndodh për termin *hedhje themelesh me çpusim*, (426) ku vetë fjala *çpusim* nuk pasqyrohet në fjalor si term më vehte. Gjithashtu janë sajuar fjalë-termat *dërrasim* (177), *tullë e melluar* (1461), *vetullim* (1565) etj., ndërsa temat e tyre prodhuese që nuk ekzistojnë në gjuhën shqipe deri më sot, nuk janë pasqyruar as në fjalor si terma më vehte; mendojmë se ato mund të pasqyroheshin për të treguar edhe mundësitë fjalëformuese të termit të dhënë.

Formimi i disa fjalë-termave nuk është bërë i goditur, në mënyrë që të mbulojnë krejt nocionin që shënon fjala. Kështu p.sh. fjalë-termi *dritushë-a* (rus. *ОКОШКО*, fr. regard) të jep më shumë përshtypjen e një drite të vogël se sa të dritares së vogël. Edhe fjalë-termi *banishtë fabrike* (77), mbase nuk justifikon nocionin që duhet të shprehë. Nocionin rus. *крюк арматурного стержня* fr. *crochet de l'armature*, mund ta shprehte me mirë fjalë-termi *gremçë*. Gjithashtu mendojmë, se nocionin rus. *сжать*, fr. *comprimer*, do ta shprehte me mirë fjalë-termi *shtyp*. Ndoshta për këtë arsye është përdorur fjala *shtypje* në termin *zonë e shtypjes së betonit* (rus. *сжатая зона бетона* fr. *zone comprimée du béton*).

Disa herë, për të shfrytëzuar sa më shumë mundësitë që ka gjuha jonë për fjalë-terma dhe prirjen që ka marrë zhvillimi i gjuhës letrare në kohën tonë, kuptimi i disa fjalëve të fondit të gjuhës sonë është zgjeruar dhe shtrirë përtej sferës së ngushtë të jetës praktikore, ose është adaptuar kuptimi i tyre për të shprehur koncepte të përpikta dhe abstrakte të kësaj dege të shkencës. Kështu është vepëruar, për shembëll, me fjalët *ancak-u*, *cak-u*, *cung-u*, *vastak-u*, të cilat janë përdorur si fjalë-terma, respektivisht, për fr. *console*, *terme*, *tambour de colonne* (*cung shtylle*).

Termet shkencore ndërkombëtare përbëjnë gati 30% të fjalë-termave të fjalorit psh. *agora-ja* (5), *antefiks-i* (27), *ekzedër-ra* (240), *hatorik-e* (424), *labirint-i* (611), *profil-i* (981), *standartizim-i* (1174), *tetrastil-i* (1396) etj. Si terma ndërkombëtare janë quajtur ato, që përdoren njëjloj, jo vetëm në dy ose më shumë gjuhë latine a neolatine por që përdoren dhe në gjuhët e tjera jolatine.

1) A. Kostallari : «Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalë-formuese», Bul. U. Sht. Tiranë, Seria Shk. Shoq. 1962, Nr. 3, f: 23:

Komisioni i terminologjisë së këtij fjalori është përpjekur, që, siç thuhet në parathënie, në 'të «mos kishte terma sinonime» sepse sinonimia për natyrën e këtyre fjalorëve do të ishte e padëshirueshme. Megjithatë, këto përpjekje nuk janë kurorëzuar gjithnjë me sukses. Problemi i njësimit të terminologjisë së arkitekturës do të zgjidhej me mirë në qoftë se do të ishte i mundur evitimi në maksimum i termave dyfishe, që paraqiten në fjalor me shenjën «ose». Termat sinonime të këtij fjalori janë të karaktereve të ndryshëm: 1) Ka nga ato, që krahas me termin shqip mbetet dhe ai i huaj; p.sh. *hangar ose strehore* (377), *rotonde ose ndërtesë rrumbullake* (829), *rend kompozit ose rend i përbërë* (1074). Për t'i shërbyer çështjes së njësimit të terminologjisë, unifikimit të termave, do të ishte mirë sikur secila prej këtyre fjalë-termave të huaja të hiqej.

Në këtë fjalor një sasi të madhe të fjalë-termave, gati 10%, e përbëjnë fjalë-termat turqisht psh. *beden-i* (16), *çardak-u* (127), *çati-a* (128-140), *dysheme-ja* (224), *taban-i* (1380), *tavan-i* (1385) etj. Kjo sasi e madhe e turqizmave shpjegohet me faktin se fjalë-termi turqisht, i cili ka kohe që përdoret si i tillë, më saktë shpreh nocionin korespondues dhe nuk është gjetur me vend eliminimi i tyre i plotë. Por, megjithatë, në rastet kur propozohen dy fjalë-terma sinonime, njera prej tyre me origjinë turke mund të hiqej si psh. *hajat-i* (376), *çati-a* (128), bile dhe *qerpiç-i* (1062) ose dhe *tokmak-u* (1409), 2) Ka në fjalor fjalë-terma sinonime ose më mirë dublete, të cilat dalin si variante morfologjike të dy dialekteve kryesore të shqipes psh. *këndth-i* ose *kandth-i* (521), *lidhje me mbivënie* ose *lidhje me mbivumje* (653), *pjesë e paranderur* ose *pjesë e parandeme* (945), *thyerje* ose *thyemje* (1506). Paraqitja në këtë mënyrë e këtyre termave na duket se nuk i shërben njësimit të terminologjisë. Po kështu paraqitja e termit *hapësirë e traut* ose *hapësirë trari* (386) në dy forma morfologjike të gjinisë së emrit *tra* nuk ndihmon ngulitjen e një forme të vetme.

Në fjalor është praktikuar dhe mënyra e paraqitjes së fjalë-termave sinonime me shenjën «shih». Kjo mënyrë që shërben për të treguar pasurinë e fjalë-termave shqipe të cilat shprehin të njëjtin nocion, na duket me e këshillueshme, se sa ajo me «ose».

Nga ana fonetike, në formimin e fjalë-termave të arkitekturës, hartuesit e fjalorit kanë anuar më shumë nga fonetika e gegërishtes. Kjo vihet re psh. në fjalë-termat *kambatis* (477-478), me një *a* nazale përpara një konsonanti nazal, ose në termat *kumbonë-a* (586), *landëtar-i* (614), *qepatë e ndërmyeme* (1047); por nuk mungojnë dhe format fonetike toske psh. *dhëmbëza-t* (229) *ndërdhëmbëzim-i* (812) etj. Është preferuar forma me metatezë e fjalë-termit *këpurdhë-a* (523) në vend të formës primare pa metateze *kërpudhë-a* (shih Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954). Në fjalor nuk është përdorur e njejta ortografi për fjalë-termin *egjyptian*, i cili del nganjëherë me *-y-* (shih 273) dhe nganjëherë me *-i* (shih 487, 1184).

Hartuesit e fjalorit kanë bërë formime të bukura termash njëfjalëshe, me qenë se fjalë-termat prej dy ose më shumë fjalësh sjellin pështjellim në ndërtimin e fjalive e të frazave. Por, megjithatë, mund të bëhej më shumë në këtë drejtim duke zëvendësuar fjalë-termat *derë me dy kënata* (167), *derë me një kënatë* (168) ose *dritare me dy flegra* (205), respektivisht me fjalë-termat *derë dykanatëshe*, *derë njëkanatëshe* ose *dritare dyflegrashe*, të formuara sipas modelit (*shtëpi*) *dykatëshe*. Terminologjia e arkitekturës me këtë fjalor është pasqyruar

më e plotë se sa ajo e ndërtimit, prandaj, siç duket, edhe fjalori ka marrë atë titull.

Është për t'u lavdëruar puna e palodhur e bërë prej hartuesve të fjalorit, të cilët po u japin punonjësve të prodhimit të kësaj dege të shkencës një fjalor terminologjik të hartuar mbi baza të vërteta shkencore, i cili është një kontribut i ri për terminologjinë shqipe në zhvillim, për një terminalogji që shfrytëzon fondin leksikor të gjuhës kombëtare dhe modelet e saj të fjalëformimit. Fjalë-termat *ballë-i* (69), *ballëz-a* (72), *deltinë-a* (163), *strehore-ja* (1217), *kundërerë-a* (589), *hip-tor-i* (446), *ndërkat-i* (813), *shpatinë-a* (1290), *vetqendrese e betonit* (1562) e shumë të tjera të krijuara me shije sipas natyrës së gjuhës shqipe, do të priten me dashamirësi nga «pedagogët e shkollave të larta, arsimtarët e çdo kategorie, specialistët, teknikët dhe gjithë punonjësit që janë të interesuar për daljen e kësaj terminologjie»¹, të cilëve u takon edhe detyra ta zbatojnë këtë besnikërisht në shkolla, në laboratore, fabrika e punishte për hir të dashurisë që ata duhet të ushqejnë për gjuhën tonë amtare.

Miço Samara

¹) Shih parathenien e fjalorit fq. 9.